

Në bazë të Konkluzionit të Qeverisë 05 nr 401-4733/2019 të datës 16 maj 2019, Shërbimi i Trupit Koordinues i Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë (në tekstin e mëtejshëm Shërbimi i Trupit Koordinues) shpall

K O N K U R S

për ndarjen e bursave për nxënësit e shkollave të mesme në territorin e komunës së Preshevës për periudhën e vitit shkollor 2019/2020

I - NUMRI I SHFYTËZUESVE DHE KUSHTET E KONKURSIT

Për nxënësit e shkollave të mesme në territorin e komunave Preshevë, Bujanoc dhe Vrajë, themelues i të cilave është Republika e Serbisë ose njësia e vetqeverisjes lokale, Shërbimi i Trupit Koordinues për nxënësit e shkollave të mesme ndanë bursë në vlerë mujore prej 6.000 dinarëve, për periudhën shkollore nga 1 shtatori deri më 31 dhjetor të vitit 2019. Po nëse sigurohen mjete në buxhetin për vitin 2020, Shërbimi i Trupit Koordinues do të vazhdojë dhënien e bursave deri në mbarimin e vitit shkollor 2019/2020.

Kushtet e përgjithshme janë, që nxënësit të kenë shtetësi të Republikës së Serbisë **dhe vendbanim në komunën e Preshevës** dhe për herë të parë të vitit shkollor 2019/2020, të kenë regjistruar vitin e parë, dytë, tretë dhe të katërt në njërat nga shkollat e mesme të themeluara me vendimin e Ministrisë së Arsimit të Republikës së Serbisë, që gjatë shkollimit të mëparshëm të kenë arritur sukses të shkëlqyeshëm ose shumë të mirë dhe që gjatë shkollimit të mëparshëm të mos kenë përsëritur asnjë vit shkollor.

Në konkursin mbi ndarjen e bursave për nxënësit e shkollave të mesme mund të paraqiten nxënësit e vitit të I të shkollës së mesme të cilët në të gjitha vitet nga klasa e V deri në klasën e VIII të shkollës fillore kanë arritur sukses të shkëlqyeshëm ose shumë të mirë (nga 3,50 deri 5), përkatësisht nxënësit nga viti i II deri në vitin e IV të shkollës së mesme të cilët në të gjitha vitet e mëparshme të shkollës së mesme kanë arritur sukses të shkëlqyeshëm ose shumë të mirë (nga 3,50 deri 5) dhe të cilët kanë pasur sjellje shembullore (5).

Bursa do t'i fitojnë vetëm ata nxënës të cilët ndjekin vitin shkollor 2019/2020 në shkollat në territorin e Preshevës, Bujanocit dhe Vrajës dhe në momentin e dorëzimit të lutjes kanë vendbanim në territorin e Preshevës.

Nxënësit të cilët vetëm se kanë realizuar të drejtën në njërën nga bursat për nxënës nga buxheti i Republikës së Serbisë nuk kanë të drejtë për shfrytëzimin e bursës së Shërbimit të Trupit Koordinues, ndërsa nëse ndërkohë fitojnë të drejtën e ndonjë burseje tjetër, janë të detyruar që të përcaktohen për njërën nga bursat e ndara. Shërbimi i Trupit Koordinues ka të drejtën që të verifikoj kandidatët e bursave se a kanë arritur të drejtën për bursë nga ndonjë organ tjetër shtetëror i cili financohet nga buxheti i Republikës së Serbisë ose vetqeverisjes lokale.

Shërbimi i Trupit Koordinues në përputhje me buxhetin për vitin 2019, ka në dispozicion të mjeteve financiare për **300 bursa**.

Shërbimi i Trupit Koordinues numrin prej **300 bursave në dispozicion** do t'ia ndajë nxënësve: nga komuna e Bujanocit **41,5%**, përkatësisht **124 bursa**, nga komuna e Preshevës **38,5%**, përkatësisht **116 bursa** dhe nga komuna e Medvegjës **20%**, përkatësisht **60 bursa**. Në rast se njëra nga komunat nuk do të ketë numrin e mjaftueshëm të bursistëve për kuotën e cila është përcaktuar paraprakisht, vendet e lira do t'i barten dhe në mënyrë të barabartë t'i ndahen komunave tjera sipas përqindjeve paraprakisht të përcaktuara.

II - DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR PARAQITJE NË KONKURS

- Aplikacioni i plotësuar për ndarjen e bursës në formularin e Shërbimit të Trupit Koordinues i bashkangjitur në konkurs (**formulari Shërbimi i Trupit Koordinues numër 1**),
- Vërtetimi të cilin e vërteton shkolla në të cilën nxënësi e ndjek mësimin, **me të dhënat e obligueshme** mbi regjistrimin në njërin nga vitet e shkollës së mesme në territorin e komunave Preshevë, Bujanoc dhe Vrajë të vitit shkollor 2019/2020, **suksesin e arritur** në vitin e mëparshëm dhe të dhënë se kur për herë të parë ka regjistruar vitin e parë të shkollës së mesme (**formulari i Shërbimit të Trupit Koordinues numër 2**)
- Kopjet e vërtetuara të dëftesave për të gjitha vitet shkollore të përfunduara (**për nxënësit e vitit të parë të shkollës së mesme kopja e vërtetuar e dëftesave nga klasa V deri në klasën e VIII të shkollës fillore, si dëshmi i suksesit të arritur në shkollën fillore në të cilën kandidati e ka kryer. Për nxënësit e vitit të dytë, tretë dhe katërt të shkollës së mesme kopjet e vërtetuara të dëftesave rreth suksesit të arritur në të gjitha vitet e shkollës së mesme, të cilën e lëshon shkolla e mesme në të cilën kandidati ndjek mësimin**),
- Çertifikata e vdekjes nga libri amëz i të vdekurve, nëse nuk kanë njërin apo të dy prindërit dhe vërtetimin mbi kujdestarinë (**origjinalin të cilin e jep organi kompetent i administratës komunale ose kopjen e vërtetuar të cilën e vërteton noteri**),
- Vërtetimi i të ardhurave mesatare mujore për çdo anëtarë të familjes të nxënësit (**formulari i Shërbimit të Trupit Koordinues me numër 4**) të cilin e vërteton organi në komunën e vendbanimit, dhe i cili lëshohet në bazë të deklaratës të dhënë rreth anëtarëve të familjes në prani të dy dëshmitarëve dhe dëshmimeve të duhura rreth të ardhurave të arritura të familjes për periudhën nga 1 janar deri në 30 qershor të vitit 2019 (**formulari i Shërbimit të Trupit Koordinues me numër 3**).
- **Të dhënat e lexuara elektronike të letërnjoftimit apo fotokopjen e letërnjoftimit të vjetër me afat të nxënësit**, përkatësisht të dhënat e shtypura nga letërnjoftimi elektronik apo fotokopja e letërnjoftimit të vjetër me afat e prindit apo kujdestarit po nëse nxënësi ka më pak se 16 vjet,
- **Katër shembuj të Kontratët mbi Bursë** të cilat janë të plotësuara në mënyrë të rregullt dhe të nënshkruar nga ana e nxënësit dhe prindit apo kujdestarit të nxënësit.

Dokumentet e konkursit nuk kthehen.

Dokumentet e theksuara, konkretisht dëshmit, lëshohen dhe vërtetohen nga shërbimet përkatëse, të cilat janë:

- **formularin e Shërbimit të Trupit Koordinues me numër 2**, e vërteton shkolla e mesme të cilën nxënësi e ndjek mësimin,
- **formularin e Shërbimit të Trupit Koordinues me numër 3 dhe 4**, e vërteton organi kompetent i administratës komunale në komunën e vendbanimit,
- **kopjet e dëftesave** i vërteton noteri
- **çertifikatën e vdekjes nga libri amëz i vdekjes**, nëse nuk kanë njërin apo të dy prindërit dhe vërtetimin mbi kujdestarinë e lëshon organi kompetent i administratës komunale, ndërsa kopjen e vërteton noteri
- **shembullin e Kontratës mbi Bursën** mund ta merrni në ueb faqen e Trupit Koordinues në adresës www.kt.gov.rs ose për nxënësit e shkollave të mesme nga komuna e Preshevës në zyrën e Shërbimit të Trupit Koordinues në Preshevë (rruga Sava Kovaçević nr. 12).

VËREJTJE: Të gjitha dokumentet e nevojshme për paraqitje në konkurs duhet të jenë të plotësuara në mënyrë të rregullt dhe me shkrim të lexueshëm. Është e nevojshme që kandidati, numrin e llogarisë bankare dhe emrin dhe adresën e saktë të bankës ta shënoj në shembullin e kontratës mbi mbursë dhe në formularin e paraqitjes për ndarjen e bursës për nxënës (formularin e Shërbimit të Trupit Koordinues nr 1) me rastin e dorëzimit të dokumentacionit të konkursit.

III - AFATI I PARAQITJES DHE DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT

Afati për paraqitje në konkurs është prej 25 shtatorit deri më 11 tetor 2019, deri në ora 15:30.

Lutjet për ndarjen e bursës dhe dokumentet me cilat dëshmohet përmbushja e kushteve, dorëzohen në zarfin e mbyllur. Në anën e pasme të zarfit është e domosdoshme të shënohet emri dhe mbiemri i aplikuesit të lutjes dhe adresa e aplikuesit të lutjes. Në pjesën e përparme të zarfin duhet të shënoni vërejtjen: **ZA KONKURS ZA DODELU STIPENDIJA UČENICIMA SREDNJIH ŠKOLA NA PODRUČJU OPŠTINE PREŠEVO ZA PERIOD ŠKOLSKE 2019/2020 GODINE – NE OTVARATI PRE ISTEKA ROKA ZA KONKURISANJE**

Për nxënësit e shkollave të mesme nga komuna Preshevës, paraqitjet dorëzohen në zyrën e Shërbimit të Trupit Koordinues në Preshevë (rruga Sava Kovaçević 12). Organi i cili pranon lutjen, të njëjtën e vulos si dhe shënon datën se kur është dorëzuar lutja.

Dokumentacioni i konkursit i cili nuk dorëzohet me kohë dhe i nuk është i kompletuar nuk do të merret në shqyrtim.

IV - NDARJA E BURSËS

Komisioni i formuar me vendimin e u.d së drejtoreshës së Shërbimit të Trupit Koordinues do të përpilojë ranglistat e posaçme të kandidatëve në nivel komunash.

Kriteret për përpilimin e ranglistës janë:

- nxënësve të cilëve të dy prindërit i kanë vdekur **30 poena**;
- nxënësve të cilëve njëri nga prindërit i ka vdekur **25 poena**;
- nxënësit të cilët jetojnë në familjet të cilat kanë të ardhura mujore për anëtar nga 0 - 15.000,00 dinarë **20 poena**;
- nxënësit të cilët jetojnë në familjet të cilat kanë të ardhura mujore për anëtar nga 15.001,00 dhe më shumë dinarë **15 poena**;
- për sukses të shkëlqyeshëm në vitin e mëparshëm **15 poena**;
- për sukses shumë të mirë në vitin e mëparshëm **10 poena**;

Në rast se dy apo më shumë kandidatë e kanë numrin e njetë të poenave, Komisioni do t'i japë përparsi kandidatit i cili ka mesatarën më të lartë në vitin e kaluar të përfunduar.

Në rast se ka dy apo më shumë kandidatë të cilët kanë mesatarën e njetë për vitin e kaluar të përfunduar, Komisioni do t'i japë përparsi atij kandidati i cili e ka notën mesatare gjatë shkollimit të kaluar (mblidhen mesataret e gjitha viteve të kaluara dhe pjesëtohen me numrin e viteve të shkollimit).

Komisioni do t'i shqyrtojë të gjithat lutjet e arritura në kohë, do t'i vlerësoj të gjitha lutjet të cilat përmbushin kushtet e konkursit dhe do të përpiloj **ranglistën preliminare** të nxënësve cilët do të fitojnë bursën në bazë të numrit të poenave dhe në përputhje me kriteret. Në bazë të rang listës së përcaktuar, Komisioni do të sjellë Vendim mbi Zgjedhjen e Bursistëve të cilin e nënshkruan kryetari i Komisionit.

Kandidatët për ndarjen e bursave të cilët nuk janë të përzgjedhur në Vendimin mbi Ndarjen e Bursave, kanë të drejtë në ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të Vendimit të Zgjedhjes së Bursistëve, ndërsa në përputhje me nenin 32 dhe 147 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative. Ankesa i parashtrohet u.d së drejtoreshës së Shërbimit të Trupit Koordinues të Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, përmes Komisionit. Në ankesë duhet të theksohen arsyet për parashtrimin e ankesës dhe arsyeshmëria, përkatësisht me të duhen të dorëzohet edhe dokumentacioni i duhur dëshmues. Ankesa e cila nuk është dërguar me kohë apo e cila është dërguar nga ana e personit të paautorizuar do të hidhet poshtë. Mbi ankesën vendos u.d së drejtoreshës së Shërbimit të Trupit Koordinues, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të ankesës. Vendimi i u.d së drejtoreshës së Shërbimit të Trupit Koordinues është përfundimtar në procedurën administrative.

Rang listat përfundimtare pas vendosjes në bazë të ankesave, do të vendosen në zyrën e Trupit Koordinues në Preshevë, tabelat e shpalljes të shkollave të mesme dhe në ueb faqen e Trupit Koordinues (www.kt.gov.rs).

Në bazë të rang listës përfundimtare mbi ndarjes e bursave të nxënësve, pas vendimarrjes rreth ankesave, nxënësit, përkatësisht prindi apo kujdestari i nxënësit nënshkruan kontratë mbi ndarjen e bursës me Shërbimin e Trupit Koordinues, me të cilën rregullohen ngushtë të drejtat dhe detyrimet në lidhje me shfrytëzimin e bursës. Bursa ndahet pa detyrimin për t`u kthyer.

Shfrytëzuesit të bursës i pezullohet pagesa e bursës së miratuar në rast të dhënave jo të sakta të reguara, kur në të njëjtën kohë merr bursë, kredi ose ndonjë formë të njëjtë të përfitimit në baza tjetra nga buxheti i Republikës së Serbisë ose vetqeverisjeve lokale, kur të humb të drejtën e finansimit të shkollimit nga buxheti ose heqë dorë nga shkollimi i rregullt.

Pas përfundimit të konkursit shembujt e kontratës Shërbimi i Trupit Koordinues do t`ia dorëzoj shkollave dhe komunave.

V SHUMA E BURSAVE DHE PAGESA

Bursa paguhet në një shumë neto prej 6.000 dinarë për muajt shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2019, dhe nëse sigurohen mjete në buxhetin për vitin 2020, atëherë do të paguhet në kontinuitet deri në fund të vitit shkollor 2019/2020.

VËREJTJE: Bursat paguhet në xhirlogarinë bankare të prindërit apo kujdestarit të nxënësit.

VI - FORMULARËT E KONKURSIT

Formularët për këtë konkurs mund të merren në vendin ku edhe dorëzohen lutjet, mirëpo mund të merren edhe në ueb faqen e Trupit Koordinues në adresën: www.kt.gov.rs.

Informacionet shtesë mund të merren duke dërguar pyetjet në fax 011/21-20-909 ose në e-mail: office@kt.gov.rs, goran.gavrilovic@kt.gov.rs, milutin.jovanovic@kt.gov.rs ose me dorëzimin e pyetjeve personalisht ku dorëzohen lutjet apo me postë të rekomanduar në adresën:

Shërbimi i Trupit Koordinues i Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, Bulevar Mihajlla Pupina 2, 11070 Novi Beograd.